



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, KONTROLLIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT**

KORÇË MË ___/___/2023

RELACION

**“PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË KORÇË TË PASURISË NR.40/4 DHE 40/5 ZONË KADASTRALE 1446 ME
SIPËRFAQE 183 M2 TRUALL DHE 107.5 M2 NDËRTESË ME VENDNDODHJE NË
DARDHË, NJA DRENOVË, BASHKIA KORÇË SIPAS GENPLANIT
BASHKANGJITUR”**

Bazuar në vendimi nr.742, datë 8.9.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Drenovë të Qarkut të Korçës” Bashkisë Korçë i janë transferuar në pronësi një listë pronash të ndodhura në njësinë administrative Drenovë, përfshirë këtu prona të ndodhura në fshatin Dardhë.

Në këto prona të transferuara nuk bën pjesë prona me nr.40/4 dhe 40/5 zk 1446, godinë e pashfytëzuar në fshatin Dardhë, “ish posta e fshatit” në pronësi shtetërore, e patransferuar në pronësi apo në përdorim të asnjë organi administrativ.

Nëkuadër të investimeve që Bashkia Korçë ka për qëllim të realizojë në këtë pasuri në përmbushjen e funksioneve të saj ligjore, nevojitet kalimi në pronësi të Bashkisë Korçë të **pasurisë nr.40/4 dhe 40/5 zk 1446 truall + ndërtesë, sipas genplanit bashkëngjitur** këtij relacioni. Në funksion të zhvillimit të aktivitetit administrativ të kryesisë së fshatit Dardhë nevojitet kjo sipërfaqe ndërtesë + truall. Për këtë qëllim kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Korçë autorizimin për fillimin e procedurave të transferimit në pronësi të Bashkisë Korçë të kësaj pasurie.

Pas verifikimeve të kryera në terren nga ana e specialistëve të Bashkisë Korçë sipërfaqja e përgjithshme për transferim në favor të Bashkisë Korçë është pasuri e llojit truall+ ndërtesë, pasuri nr.40/4 dhe 40/5 ZK 1446, me sipërfaqe faktike 183 m2 truall dhe 107.5 m2 ndërtesë.

Bazuar në sa u tha më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Korçë të autorizojë fillimin e procedurave nga ana e Bashkisë Korçë, për transferimin e pasurive nr.40/4 dhe 40/5 ZK 1446, me sipërfaqe faktike 183 m2 truall dhe 107.5 m2 ndërtesë me vendndodhje në fshatin Dardhë, Njësia Administrative Drenovë, Bashkia Korçë.

Si rrjedhë, bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërmat a) “njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e tyre të paluajtshme sipas mënyrës së përcaktuar në ligj” dhe c) “e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës” të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe bazuar në ligjin 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, njësi të qeverisjes vendore” dhe ligjit Nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" Neni 40 "Ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit dhe transferimi" i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të autorizojë fillimin e procedurave për transferimin në pronësi të Bashkisë Korçë, të pasurive nr.40/4 dhe 40/5 ZK 1446, me sipërfaqe faktike 183 m2 truall dhe 107.5 m2 ndërtesës sipas genplanit bashkangjitur këtij relacioni.

Bashkangjitur këtij relacioni:

- Genplani i pasurisë nr. 40/4 dhe 40/5 zk 1446, Dardhë.

Drejtoreshë Përgjithshme
Anxhela (Dishnica) Qeramixhi Zhaneta Lubonja

Drejtoreshë e DPKZHT

KRYETARI

Sotiraq FILO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr _____, datë ____/____/2023

**‘PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË KORÇË TË PASURISË NR.40/4 DHE 40/5 ZONË KADASTRALE 1446 ME
SIPËRFAQE 183 M2 TRUALL DHE 107.5 M2 NDËRTESE ME VENDNDODHJE NË
DARDHË, NJA DRENOVË, BASHKIA KORÇË SIPAS GENPLANIT
BASHKANGJITUR’**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe DPKZHT bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërma a) të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe bazuar në ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, njësi të vetëqeverisjes vendore” dhe VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave organeve të qeverisjes vendore” dhe bazuar në Ligjin 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” neni 40;

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurave për transferimin në pronësi të Bashkisë Korçë të pasurive nr.40/4 dhe 40/5 ZK 1446, me sipërfaqe faktike 183 m2 truall dhe 107.5 m2 ndërtesë, sipas genplanit bashkangjitur këtij relacioni, me vendndodhje në fshatin Dardhë, Njësia Administrative Drenovë, Bashkia Korçë.
2. Qëllimi i transferimit është përdorimi i kësaj prone për zhvillimin e aktivitetit administrativ të kryesisë së fshatit Dardhë.
3. Përzbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerzore dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimi të Territorit, Bashkia Korçë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇIKRYETARI

ANA VERUSHI

Miratuar me _____vota

Vota Pro_____

Vota Kundër_____

Vota Abstenim_____

Zbardhur më datë_____